Ilmi Ismahedi
Evisela Sefo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

QËNDRA E ARSIMIT

Nr. 541 Prot. Lushnje më, 14 / 01 /2026

RELACION
"PËR MIRATIMIN E PRISHJES SË OBJEKTIT GARAZHD TE ISH-GJENDJA CIVILE, LAGJA "XHEVDET NEPRAVISHTA" BASHKIA LUSHNJE."

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

Të nderuar: Këshilltare/Këshilltarë

Qëndra e Arsimit Bashkia Lushnje është duke kryer rikonstruksionin e objektit i emërtuar ish-Gjendja civile, e llojit truall + ndërtesë me sipërfaqje 420 m2 dhe 232 m2 ndërtesë , i regjistruar në pasurinë me nr. 23/14, ZK 8571, lagjia "Xhevdet Nepravishta", Bashkia Lushnje dhe është drejt përfundimit të punimeve me qëllim përgatitjen e tij për funksionimin si kopësht me drekë për fëmijët. Janë kryer punimet në tri arsët e objektit të termoizolimit dhe rifiniturës, ndërsa mbetet vetëm pjesa e pasme, pjesa veriore objektit.

Për të kryer dhe këtë proces, kërkojmë miratimi e eleminimit, prishjes së garazhit në pjesën e pasme, 17 m2 për arsye se:

1. Ky ndërtim ka humbur funksionin e tij si garazh apo magazinë.
2. Përbën pengesë për kryrjen e punimeve dhe qarkullimin rreth objektit, sepse zë të gjithë hapësirën e mundshme në dispozicion.
3. Muret e objektit janë të ndërtuara përgjithësisht me gur gëlqeror dhe janë amortizuar dukshëm nga koha dhe lagështia dh nuk mund të riparohen.
4. Ekzistenca e këtij garazhi ngjitur r e objektin pengon largimin e ujërave sipërfaqësor të shiut dhe prezencë të lagështisë gja stinës së dimrit.
5. Eleminimi i garazhit mendojmë që krijon një hapësirë dhe akses për fuksionin e ri që do të ketë ky objekt.

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Shkalla e amortizimit është e lartë pasi materialet e përdorura për ndërtimin e këtij objekti kanë qënë cilësi e dobet.

Përsa më sipër mbështetur nenit 9 pika 1.2/a/c dhe neni 54, gërma "e", pika 1 të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar kërkojmë miratimin e vendimit të prishjes së këtij objekti nga Këshilli Bashkiak Lushnje.

Faleminderit për mirëkuptimin !

QËNDRA E ARSIMIT

Muharrem Sharka

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+35 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr. 541/1 Prot. Lushnje më, 14/01/2026

PROJEKT-VENDIM
NR. 06 DATË 14/01/2026

"PËR MIRATIMIN E PRISHJES SË OBJEKTIT GARAZHD TE ISH-GJENDJA CIVILE, LAGJA "XHEVDET NEPRAVISHTA" BASHKIA LUSHNJE."

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ____/____/2026, sipas relacionit të paraqitur nga Qëndra e Arsimit, në mbështetje të n nit 9 pika 1.2/a/c dhe neni 54, gërma "e", pika 1 të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 113, pika 2 të Kushtetutës se Republikës të Shqipërisë, nenit 4, neni 5, pika 1.3, gërma a, neni 12, neni 22 të ligjit nr.107 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe VKM-së nr. 175 datë 06.03.2012 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lushnje, të Qarkut të Fier. Ju

PROPOZOJMË:

I. Të miratoj prishjen e objektit garazhd te ish-gjendja civile, lagja "Xhevdet Nepravishta" Bashkia Lushnje me sipërfaqje 17 m2, i regjistruar si pasuri me nr. 23/14, ZK 8571.

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Qëndra e Arsimit Bashkia Lushnje dhe Njësia Adn inistive nr.2, Bashkia Lushnje.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpallljes.

DREJTORIA JURIDIKE
Bedri Hida

QËNDRA E ARSIMIT
Muharrem Sharka

KRYETARI I BASHKISË
ERISELDA SEFA

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+35 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com